



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 59/2019

Datë: 28 janar 2019

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 28 janar 2019, mori këtë:

VENDIM

- I. Aprovohet Rekomandimi i Komisionit Ad hoc për shqyrtimin e kërkesave të ish prokurorëve të shtetit z. Abdurrahim Islami dhe z. Faik Halili për kompensim pagave.
- II. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e ish prokurorit të shtetit, Faik Halili për kompensim pagave.
- III. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim të ia dërgoj ish prokurorit të shtetit z. Faik Halili.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arsyetim

Ish prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, z. Faik Halili, i cili me datë 03 shtator 2018, ka arritur moshën e pensionimit, me ç'rast ka përfunduar mandatin e prokurorit të shtetit, ka bërë kërkesë për realizimin e tri (3) pagave përcjellëse dhe tri (3) paga jubilarë me rastin e shkuarjes në pension. Këtë kërkesë ish prokurori Halili e ka bazuar në nenin 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 24 dhjetor 2018, ka themeluar Komisionin Ad Hoc për shqyrtimin e kërkesave të dy ish prokurorëve të shtetit z. Abdurrahim Islami dhe z. Faik Halili.

Komisioni e ka trajtuar kërkesën e paraqitur nga ish prokurori Faik Halili dhe ka rekomanduar që kjo kërkesë duhet të refuzohet. Këtë rekomandim Komisioni e ka dhënë pasi që institucioni i Prokurorit të Shtetit nuk është nënshkruar i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, dhe nenet 52 dh 53 të kësaj Marrëveshjeje nuk mund të

zbatohen në rastin e ish Prokurorit të Shtetit Faik Halili. Po ashtu Komisioni ka shqyrtuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.181/2018, me të cilën është aprovuar Revizioni i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për refuzimin e kërkesës së ish gjyqtares Fllanza Kadiu për kompensimin e tri pagave jubilarë dhe tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit

Duke pasur parasysh që prokurorët nuk janë të organizuar si sindikatë e pavarur mirëpo veprojnë në kuadër të Shoqatës së Prokurorëve të Kosovës, e kjo nënkupton se të njëjtit nuk janë përfitues e as obligues ndaj Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive,

Andaj, bazuar në të gjitha të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bahri Hyseni
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës



T'i dërgohet:

- Faik Halili;
- Sekretariatit;
- Arkivit të KPK-së.